



Siguria publike në nivel vendor: si organizohet në Holandë nga niveli kombëtar deri në nivelin vendor

Përpara jush paraqitet një pasqyrë e strukturës holandeze të qeverisjes në fushën e sigurisë publike vendore, në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Ky dokument është i mbushur me shembuj se si punojmë ne në Holandë për sigurinë publike në nivel vendor dhe mund të shërbejë si burim frymëzimi në bërjen e politikës së sigurisë publike vendore të Shqipërisë më reaguese dhe të efektshme dhe të përfshijë pjesëmarrjen e qytetarëve.

Dokumenti shikon nga afër bashkëpunimin ndërmjet nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor në fushën e sigurisë publike vendore. Për më tepër, ai shpjegon se si funksionon struktura e qeverisjes dhe se si përfaqësohen interesat e grupeve të ndryshme.

Siguria publike vendore është përgjegjësi që ndahet mes një game partnerësh të sigurisë në nivele të ndryshme të qeverisjes në Holandë. Këta partnerë punojnë së bashku në partneritete të ndryshme në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor në varësi të shtrirjes së çështjes. Figura 1 e shpjegon më tej.




Figura 1 Struktura e sigurisë publike vendore në Holandë

Politika e Sigurisë Kombëtare

Në Shqipëri nuk ka, në kohën që flasim, strukturë kombëtare të integruar për qeverisjen dhe politikë në lidhje me sigurinë publike vendore që do të siguronte kuadrin për përparësitë, veprimet, bashkëpunimin dhe financimin e sigurisë publike vendore. Kuadri ligjor që merret me çështjet e sigurisë publike vendore është gjerësisht i copëzuar mes legjislacionit në sektorë dhe nuk ka kërkesa specifike për krijimin e mekanizmave institucionale dhe financiare në nivel bashkie për të mundësuar zhvillimin e një kuadri politike të integruar kur bëhet fjalë për planet, strategjitë dhe programet e sigurisë publike në nivel vendor. Për më tepër, ka mbivendosje në ndarjen e detyrave mes qeverisë vendore dhe asaj qendrore për sigurinë publike në nivel vendor.

Në këtë kapitull shpjegojmë se si e organizojmë këtë strukturë në nivel kombëtar në Holandë. Në videon që vijon, Michiel Geuzinge, këshillues i lartë politike për Rendin dhe Sigurinë Publike shpjegon

partneritetet ekzistuese në nivel kombëtar në Holandë në lidhje me temën e sigurisë publike në nivel vendor. Ai përqendrohet specifikisht tek Konsultimi Strategjik i Sigurisë (Strategisch Beraad Veiligheid) dhe Këshilli i Sigurisë (Veiligheidsberaad).



Konsultimi Strategjik për Sigurinë (KSS) është organ konsultativ që përbëhet nga Ministria e Drejtësisë dhe Sigurisë, Ministria e Brendshme, Shërbimi i Prokurorisë Publike dhe Shoqata e Bashkive të Holandës. Këto organe qeveritare diskutojnë së bashku sigurinë në nivel kombëtar dhe vendor. Ato mbledhen katër herë në vit dhe angazhohen në një mori çështjesh që ndikojnë në sigurinë fizike dhe sociale të vendit. Temat e diskutuara duhet të kenë natyrë administrative dhe strategjike. Gjatë KSS-së është shumë e rëndësishme të shprehen të gjitha mendimet e ndryshme të të gjitha palëve.¹



Ndalimi i mundshëm në nivel kombëtar për ndezjen e fishekzjarrëve nga publiku

Shembull i një teme të diskutuar brenda KSS-së është nëse do të vendoset ose jo ndalim në nivel kombëtar për ndezjen e fishekzjarrëve nga qytetarët gjatë Vitit të Ri. Në Holandë qytetarët lejohen të ndezin fishekzjarrë nga ora 18.00 të datës 31 dhjetor deri në orën 02.00 të datës 1 janar. Bashkitë mund ta rregullojnë më tej këtë me rregullore të përgjithshme vendore, për shembull duke vendosur për disa zona të caktuara si zona pa fishekzjarrë, ku nuk lejohet të përdoren fishekzjarrë. U shtuan diskutimet e përgjithshme vitet e fundit në lidhje me rrezikun e përdorimit privatisht të fishekzjarrëve në vijim të një rritjeje të aksidenteve, dhe u bë thirrje për legjislacion të mëtejshëm. Deri tani qeveria ka kufizuar hapësirën kohore gjatë së cilës mund të ndizen fishekzjarrë, por ka ruajtur të drejtën e ndezjes së fishekzjarrëve nga publiku. Bashkitë kanë kompetencat të vendosin rregulla më strikte.

¹ VNG, Strategisch Beraad Veiligheid (SBV), <https://vng.nl/artikelen/strategisch-beraad-veiligheid-sbv>, (Marrë më 21 korrik, 2020)

Këshilli i Sigurisë

Këshilli i Sigurisë përbëhet nga kryetari i 25 rajoneve të sigurisë [shikoni kapitullin Politika e Sigurisë Rajonale për më tepër hollësi në lidhje me çfarë është një rajon i sigurt] dhe funksionon si platformë kombëtare për rajonet e sigurisë. Rajonet e sigurisë kanë detyrë të organizojnë shërbimet zjarrfikëse, menaxhimin e fatkeqësive dhe krizave dhe ndihmën mjekësore. Duke qenë se ky këshill në tërësi pozicionohet në lidhje me çështjet e sigurisë publike, ai është partner i rëndësishëm bisedimesh me Ministrinë e Drejtësisë dhe Sigurisë në Holandë kur bën marrëveshje që lidhen me menaxhimin e fatkeqësive dhe krizave. Kjo është arsyeja pse Ministri i Drejtësisë dhe Sigurisë bëhet gjithashtu pjesë e këshillit gjatë dy prej katër takimeve vjetore të tij.²

Shoqata e Bashkive të Holandës

Shoqata e Bashkive të Holandës (SHBH) luan rol të rëndësishëm në të dyja organet. Ajo përfaqëson interesin e gjithë 255 qeverive vendore dhe angazhon qeverinë qendrore në të gjitha aspektet e sigurisë publike në nivel vendor. Për këtë qëllim, SHBH-ja punon ngushtësisht me Konsultimin Strategjik për Sigurinë dhe Këshillin e Sigurisë. Për shembull, presidenti i SHBH-së është anëtar i delegacionit të Konsultimit Strategjik për Sigurinë. Ky bashkëpunim është i dukshëm gjithashtu në faktin se Këshilli i Sigurisë përshtat drejtimin e tij me bordin e menaxhimit të SHBH-së si edhe me Shefin e Policisë Kombëtare. Së fundi, presidenti i Këshillit të Sigurisë është nënpresident i bordit të menaxhimit të SHBH-së.³



Figura 2 Hartimi i Konsultimit Strategjik të Sigurisë

² Veiligheidsberaad, Het Veiligheidsberaad, <https://www.veiligheidsberaad.nl/>, (Marrë më 21 korrik, 2020)

³ VNG, Openbare orde en veiligheid, <https://vng.nl/rubrieken/openbare-orde-en-veiligheid>, (Marrë më 21 korrik, 2020)

Politika Rajonale e Sigurisë

Holanda është e ndarë në 25 rajone sigurie, të cilat janë të gjitha të përkushtuara për sigurinë e banorëve dhe vizitorëve në atë zonë. Ky përkushtim vjen me një përgjegjësi dhe disa detyra në fushën e shërbimit zjarrfikës, ndihmës mjekësore, rendit publik, sigurisë dhe menaxhimit të fatkeqësive dhe krizave. Një ndër përgjegjësitë kryesore të rajonit të sigurisë është përgjegjësia e tyre për të parandaluar dhe luftuar zjarret dhe, si rrjedhojë, ai duhet të sigurojë praninë e skuadrave të zjarrfikësve. Përgatiten gjithashtu për rreziqe, fatkeqësi dhe kriza duke krijuar një qasje dhe profil risku për secilin rajon. Profili i riskut përgatit rajonin për aksidentet që ka gjasa më shumë të ndodhin atje. Më pas, koordinimi, kontrolli dhe lufta ndaj këtyre fatkeqësive dhe krizave do të jetë gjithashtu nën përgjegjësinë e tyre.

Bordi i një rajoni sigurie përbëhet nga të gjithë kryebashkiakët e bashkive anëtare, pasi kryetarët e bashkive në Holandë janë përgjegjës për reagimin e shpejtë e të duhur gjatë riskut, fatkeqësive dhe krizave në bashkinë e tyre. Kryetari i bashkisë më të madhe është përgjithësisht kryetar i rajonit të sigurisë. Ky person është i autorizuar dhe përgjegjës kur ndodh një risk, fatkeqësi ose krizë në disa bashki të rajonit. Nëse një krizë kalon përtej nivelit rajonal dhe arrin shkallën kombëtare, si për shembull gjatë një përmytjeje të madhe ose një pandemie gripi, futet në lojë qeveria qendrore.

GRIP

Grip 1) Incidentet e përditëshme, të menaxhuara nga vetë shërbimet e emergjencave;

Grip 2) Incidentet më serioze, ku nevojiten masa jashtë skenës së incidentit;

Grip 3) Situatat me revolta sociale. Kryetari do të përfshihet bashkë me një ekip bashkiak politike dhe përfaqësues të organizatave kryesore të përfshira;

Grip 4) Kur një fatkeqësi ose krizë i kapërcen kufijtë e bashkisë, ngarkohet përgjegjës kryetari i rajonit të sigurisë dhe formohet një ekip rajonal i politikës (ERP);

Grip 5) Kur incidenti përfshin disa rajone sigurie, kryetarët e këtyre rajoneve të sigurisë mundën së bashku të zgjerojnë masat, ku kryetari i rajonit ku nisi incidenti merr rolin koordinues.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i mirë mes strukturave të qeverisë, kompanive dhe banorëve është thelbësor për reagimin e duhur në secilin rast, pasi përfshihen zakonisht shumë aktorë të fushave të ndryshme. Që kjo të garantohet, çdo rajon sigurie duhet të pajtohet me të njëjtën procedurë menaxhimi emergjencash mbarëkombëtare, e cila quhet Procedura e Koordinuar Rajonale për Menaxhimin e Incidentit (GRIP).⁴ Struktura e GRIP-it luan rol të rëndësishëm në zgjerimin e masave gjatë një fatkeqësie ose krize. Zgjerimi i masave bëhet bazuar në shkallën e seriozitetit dhe shtrirjes së ngjarjes. Kjo procedurë dallon pese shkallë të shtrirjes së një incidenti dhe i mundëson rajonit të sigurisë të reagojë shpejt ndaj një situatë duke dërguar njerëzit e duhur në vendngjarje. Prandaj, përgjegjësitë dhe

⁴ CCV, Grip Structuur, <https://www.raadsledenveiligheid.nl/crisisbeheersing/grip-structuur>, (Marrë më 21 korrik, 2020)

kompetenca mund të ndryshojnë në rast të shtimit të masave. Në kutinë vijuese shpjegohen nivelet e ndryshme të shtimit të masave.⁵

Në këtë video, Rob Kooij, këshilltari i kryebashkiakut të Diemen-it për menaxhimin e krizave prezanton rajonin e sigurisë Amsterdam-Amstel dhe shpjegon çështjet kryesore në të cilat përfshihet rajoni i sigurisë.



Bijlmerramp 1992

Në videon e tij, Rob Kooij flet për përplasjen e avionit në vitin 1992, njohur gjerësisht në Holandë si 'Bijlmerramp', e cila mori emrin sipas lagjes në Amsterdam ku ndodhi aksidenti fatal. Në 4 tetor 1992, një avion për transportimin e mallrave Boeing 747 i kompanisë izraelite El Al pati probleme mekanike menjëherë pas nisjes nga aeroporti Schiphol në Amsterdam. Avioni humbet dy prej motorëve dhe ka leje të bëjë ulje emergjence, por, gjatë aktivizimit të uljes, gjërat nuk shkojnë si duhet dhe avioni përplasët me lagjen Bijlmer, në një kënd ku janë të lidhura dy pallate, duke shkaktuar një zjarr të madh. Përdoret një ekip special shpëtimi i repartit të zjarrfikësve të Amsterdamit, për operacionin e shpëtimit dhe rikuperimit. Në fillim mendohet se qindra njerëz kishin humbur jetën, pasi në ato apartamente jetojnë shumë të paligjshëm. Numri zyrtar i vdekjeve është 43, përfshirë 3 anëtarë ekuipazhi dhe një pasagjer të avionit.

Politika e Sigurisë Vendore

Siç u përmend më parë, struktura institucionale në nivel qeveritar që ka të bëjë me sigurinë publike në nivel vendor në Shqipëri nuk është vendosur ende, as në nivel kombëtar, por as edhe në nivel vendor. Shumica e bashkive nuk kanë një dokument politike të miratuar për sigurinë publike në nivel vendor.

⁵ Rijksoverheid, Veiligheidsregio's, <https://www.rijksoverheid.nl/onderwerpen/veiligheidsregios-en-crisisbeheersing/veiligheidsregios>, (Marrë më 21 korrik, 2020)

Gjithashtu janë të kufizuara njohuritë dhe përvoja në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e qeverisë vendore për sigurinë publike vendore.

Përfshini Qytetarët tuaj

Përfshini Qytetarët tuaj

Në Shqipëri niveli i ndërgjegjësimit të komunitetit për rolin e tyre në parandalimin dhe adresimin e çështjeve lidhur me sigurinë publike vendore nuk e inkurajon atë për angazhim proaktiv me bashkinë dhe policinë në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë. Bashkia mund të fitojë shumë nga përfshirja e qytetarëve në (zbatimin e) politikave/ve të sigurisë publike vendore. Përfshijini, frymëzoni dhe angazhoni ata!

Në Holandë, përgjegjësia për zhvillimin e një politike vendore të sigurisë i takon bashkisë, ku kryetari i bashkisë ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e rendit dhe sigurisë publike. Secila bashki përfaqësohet nga kryetari i bashkisë në një nga 25 rajonet e sigurisë. Praktikisht, roli i bashkisë kërkon kryesisht koordinimin e mirë mes gjithë palëve (të sigurisë) që përfshihen në çështje të sigurisë në shkallë vendore, si për shembull Policia dhe Shërbimi i Prokurorisë Publike. Në varësi të temës, mund të përfshihen gjithashtu shumë palë të tjera, si për shembull shkollat, ekipet rajonale sociale, sipërmarrësit dhe reparti zjarrfikës. Më tej, bashkitë sigurojnë zbatimin e masave të dakordësuara me këto palë, të cilat përgjithësisht listohen në një plan zbatimi. Brenda këtij plani zbatimi shpjegohen qëllimet në lidhje me sigurinë.

Shoqata e Bashkive të Holandës (SHBH) luan rol të rëndësishëm në hartimin e këtij plani zbatimi, pasi ajo ka krijuar një metodë të përgjithshme për hartimin sipas disa hapave. Metoda përbëhet nga pesë tema të cilat duhet të përfshihen në secilin plan: (i) mjedisi i sigurt jetese, (ii) biznesi dhe siguria, (iii) rinia dhe siguria, (iv) siguria fizike dhe (v) integriteti dhe siguria.⁶



⁶ CCV, Integraal Veiligheidsbeleid, <https://hetccv.nl/onderwerpen/integraal-veiligheidsbeleid/>, (Marrë më 21 korrik, 2020)

Në këtë video, Znj. Bronsvort, kryetare e bashkisë së Oost-Gelre, shpjegon rolin e saj në lidhje me sigurinë e bashkisë së saj, si edhe çfarë kërkon roli i saj në rajonin e sigurisë dhe në Komisionin e Sigurisë dhe Qeverisjes në VNG (SHBH). Ajo shpjegon se si rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme ndahen dhe se si duke zgjidhur sigurinë vendore së bashku, ne jemi më të fortë!

Ndërtojmë të ardhme më të mirë

duke forcuar qeverisjen vendore demokratike

VNG international është e specializuar në forcimin e qeverisjes vendore demokratike në vëndet në zhvillim dhe tranzicion. Qeveritë vendore luajnë një rol kyc në sigurimin e shërbimeve bazë të tilla si furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, kujdesi shëndetsor dhe strehimi. Ato kanë ndikim të thellë në fusha si siguria, ushqimi, zbatimi i ligjit dhe të drejtat e grave. Projektet tona kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme për të ardhme më të mirë për njerëzit, komunitetet dhe vëndet.

VNG international zbaton mbi gjashtëdhjetë projekte në të gjithë botën, të financuara nga donatorë të ndryshëm përfshirë Ministrinë Holandeze të Punëve të Jashtme, Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore. Ne jemi të pozicionuar në sektorin e qeverisjes vendore Holandeze dhe kemi një rrjet shumë të gjërë ndërkombëtar ekspertësh në fushat e decentralizimit dhe administratës vendore në dispozicionin tone.

Në vitin 1993 VNG international u themelua nga Vereniging Nederlandse Gemeenten (VNG), Shoqata e Bashkive të Hollandës. Globalisht ne jemi të përfaqësuar nëpërmjet kompanisë bijë në Tunizi, sikurse edhe nga 15 zyra lokale të projekteve.

Mirënjohje

Ky projekt është i financuar nga Ministria e Jashtme e Hollandës.

Ky projekt zbatohet nga VNG International në partneritet me Akademinë e Hagës për Qeverisjen Vendore (THA) dhe Fondacionin për Autonominë Vendore dhe Qeverisjen (FLAG).



The Hague Academy for
local governance



Ministry of Foreign Affairs

July 2020

VNG International

P.O.Box 30435

2500 GK The Hague

Tel +31 70 373 8401

Fax +31 70 373 8660

vng-international@vng.nl

www.vng-international.nl

vng-international.nl